

Programi për fuqizimin e kundërveprimeve anti-trafikim në Evropën Jug-lindore: Menaxhimi i mbledhjes së të dhënave dhe i informacionit

Programi për fuqizimin e kundërveprimeve anti-trafikim në Evropën Jug-lindore: Menaxhimi i mbledhjes së të dhënave dhe i informacionit 2008-2011, ka për qëllim ngritjen e dy bazave të dhënave që të përmbajë informacione në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore, njëra me të dhëna ligjore dhe gjyqësore, dhe tjetra me të dhëna kryesisht për viktimat e trafikeve. Projekti financohet kryesisht nga qeveria Austriake dhe ajo Norvegjese.

Bazat e të dhënave do të jenë rreptësisht kombëtare dhe nuk do të shkëmbehen me asnjë institucion të jashtëm, apo qeveri tjetër, dhe as me ICPMD-në, si zbatuese e projektit. Njëra bazë e të dhënave që do të përmbajë informacione në lidhje me trafikantët, është në zotërim të Prokurorisë dhe tjetra në zotërim të Ministrisë së Brendshme. Bazat e të dhënave janë më vete dhe të instaluar në mënyrë të pavarur nga ndonjë bazë tjetër të dhënash. Bazat e të dhënave ofrojnë vendeve të përfshira në projekt dhe institucioneve të tyre mundësi qasjeje për tek informacioni statistikor, i besueshëm dhe i krahasueshëm mbi trafikimin e qënieve njerëzore. Projekti gjithashtu do të shërbejë si një mjet monitorimi për ndjekjen dhe matjen e prirjeve dhe të kundërveprimeve që do të ndërmerren në kuadër të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

Rezultatet e programit:

- Hartimi i kriterave rajonale për një sistem uniform të dhënash;
- Ngritja e dy bazave të dhënash për secilin vend pjesëmarrës të cilat janë të instaluar në institucionet përkatëse;
- Hartimi i një manuali mbi përdorimin e bazës së të dhënave, i cili do të jetë i disponueshëm në 6 gjuhë; dhe
- Zhvillimi i trajnimeve rajonale mbi përdorimin e bazave të dhënave.

Projekti do të zhvillohet në dy faza: faza e parë dhe faza e dytë, të cilat tashmë ka përfunduar:

Faza I përfshin:

- Punë kërkimore në nivel qendror – identifikimi i të dhënave ekzistuese dhe të nevojshme për analizimin e situatës së trafikimit në secilin vend të rajonit;
- Misionet vlerësimi në nivel kombëtar që do të synojnë në identifikimin e të dhënave të disponueshme dhe të krahasueshme dhe identifikimin e mbajtësve të mundshëm ku do të instalohet baza e të dhënave e përqëndruar mbi viktimën” dhe baza e të dhënave ligjore dhe gjyqësore”.
- Raporte me shkrim në ndjekje të ecurisë të hartuara së bashku me mbajtësit e dy bazave të të dhënave në secilin vend;
- Hartimi i një modeli për Memorandum Mirëkuptimi mbi përdorimin e të dhënave nga palët nënshkruese. Memorandumi i Mirëkuptimit duhet të

miratohet në vendet përkatëse nga mbajtësit e bazave të të dhënave dhe aktorët kryesorë të angazhuar në mbledhjen e të dhënave mbi trafikimin e qënieve njerëzore;

- Hartimi i një manuali mbi kriteret rajonale për një sistem uniform të dhënash;
- Përkthimi i manualit mbi kriteret rajonale për një sistem uniform të dhënash;
- Takime rajonal në lidhje me manualin.

Faza II përfshin:

- Programi i bazës së të dhënave: do të realizohet sipas kriterëve të pranuar rajonale për mbledhjen e të dhënave dhe sipas sistemit të pranuar nga palët në lidhje me mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave;
- Rifreskimi i projekt manualit mbi kriteret rajonale për një sistem uniform të dhënash sipas të dhënave shtesë dhe propozimeve të ofruara e të identifikuara gjatë mbledhjeve rajonale;
- Rishqyrtimi i projekt manualit të përkthyer mbi kriteret rajonale për një sistem uniform të dhanësh;
- Ndërtimi dhe instalimi i bazës së të dhënave;
- Përkthimi i bazës së të dhënave në 6 gjuhë;
- Trajnimi rajonal mbi përdorimin e bazës së të dhënave: do të zhvillohet nga specialistë të teknologjisë së informacionit. Nga secili vend do të marrin pjesë 2-4 pjesëmarrës në këtë trajnim.

Së shpejti pritet nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me institucionet relevante për mbledhjen dhe futjen e informacionit gjyqësor për trafikantët në bazën e të dhënave.